

Mesazhet kryesore për mjekët në spitale

Detyrat

1. Si përshkrues të antibiotikëve në spitale, detyrat tuaja lidhur me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve përfshijnë [31,42,43,52-54,56,70,71,90]:
 - a) Të përshkruani sipas udhëzimeve të bazuara në dëshmi për antibiotikët spitalorë, për infeksionet e zakonshme dhe për profilaksinë kirurgjikale;
 - b) Të identifikoni veçoritë përkatëse individuale të pacientit gjatë vlerësimit të nevojës për të përshkruar antibiotikë, duke përfshirë përdorimin e fundit të antibiotikëve, alergjitë ndaj ilaçeve, përdorimin e terapisë immunosupresive, spitalizimin ose institucionalizimin e fundit, udhëtimet e fundit jashtë Evropës dhe rezultatet mikrobiologjike në 3 muajt e mëparshëm;
 - c) Kur përshkruani një antibiotik duhet të dokumentoni në regjistrin e pacientit arsyen për trajtimin me antibiotikë, përzgjedhjen e ilaçit, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit;
 - d) Të ndiqni udhëzimet për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve;
 - e) Të siguroheni që kulturat përkatëse për diagnozë të merren para fillimit të trajtimit me antibiotikë;
 - f) Të rivlerësoni trajtimin pas 48-72 orësh, ose kur janë në dispozicion rezultatet nga mostrat mikrobiologjike;
 - g) Të filloni trajtimin me antibiotikë sa më shpejt të jetë e mundur te pacientët me infeksion të rëndë;
 - h) Të merrni parasysh profilin lokal të mikrobiologjisë dhe rezistencës ndaj antibiotikëve gjatë përshkrimit të trajtimeve empirike me antibiotikë;
 - i) T'i informoni pacientët tuaj për çdo antibiotik të përshkruar dhe efektet e tyre të mundshme negative; dhe
 - j) Të merrni pjesë në kurse vjetore trajnimi për përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve.

Gjërat që duhet të dini

2. Përdorimi i udhëzimeve për antibiotikët dhe pjesëmarrja në trajnime e përmirësojnë përshkrimin e antibiotikëve [78].
3. Dokumentimi i indikacionit, përzgjedhjes së ilaçit, dozës, mënyrës së administrimit dhe kohëzgjatjes së trajtimit në regjistrin e pacientëve rezulton në përdorim më të mirë të antibiotikëve [71].
4. Bazuar në provat e fundit, përshkrimi i antibiotikëve në kohëzgjatje më të shkurtër zvogëlon shfaqjen e bakteve rezistente ndaj antibiotikëve [54,56,71,91].

5. Koha e saktë dhe kohëzgjatja optimale e profilaksisë me antibiotikë për kirurgji rezulton në më pak infeksione në vendin e operacionit dhe zvogëlon shfaqjen e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve [73].
6. Marrja e mostrave mikrobiologjike para fillimit të terapisë empirike me antibiotikë dhe rishikimi i trajtimit me antibiotikë bazuar në rezultatet e kulturës ndihmojnë në përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve [31,70,71].
7. Rishikimi i trajtimit fillestar me antibiotikë pas 48–72 orësh dhe kalimi nga administrimi parenteral në atë oral (kur është e mundur), zvogëlon rezistencën ndaj antibiotikëve dhe përmirëson rezultatet klinike [37,54,57,71,92,93].
8. Konsultimi me ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve e rrit cilësinë e përshkrimit të ilaçeve dhe përmirëson rezultatin të pacienti [56,83].

Shembull

9. *Kalimi nga administrimi parenteral në oral i udhëhequr nga farmacisti ka rezultuar në shkurtimin e kohëzgjatjes së terapisë parenterale, pa ndikuar negativisht në rezultatet klinike [56].*
10. *Ndërhyrjet e specialistëve të sëmundjeve infektive janë shoqëruar me një përmirësim të ndjeshëm në cilësinë e përshkrimit të antibiotikëve, duke çuar në zvogëlimin e përdorimit të antibiotikëve [83].*

Gjërat që mund t'i bëni

11. Zbatoni protokollet e trajtimit me antibiotikë sipas udhëzimeve të bazuara në prova dhe zbatoni masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksionit që përcaktohen në institucionin tuaj [31] [konsensusi i ekspertëve].
12. Konsultohuni me ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve kur është e nevojshme, për shembull kur përshkruani një antibiotik jashtë udhëzimeve normale [31,56] [konsensusi i ekspertëve].
13. Filloni trajtimin me antibiotikë vetëm nëse ka prova të një infeksioni bakterial dhe mos e trajtoni kolonizimin me baktere [31,72].
14. Shmangni profilaksinë e panevojshme me antibiotikë [31,73].
15. Nëse shihni anëtarë të stafit në spital ose në mjediset e kujdesit shëndetësor që shkelin udhëzimet ose protokollet, pyetini pse po e bëjnë këtë dhe sigurojuni mjete për të kuptuar se çfarë po bëjnë gabim [konsensusi i ekspertëve].
16. Përgjigjuni pyetjeve kryesore të mëposhtme për të optimizuar terapinë me antibiotikë. Nëse keni dyshime, konsultohuni me ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve [31,42,53,70,71]:
 - a) A ka një probabilitet të lartë të një infeksioni bakterial, në vend të kolonizimit ose një infeksioni viral?
 - b) A janë marrë kulturat e duhura para fillimit të terapisë me antibiotikë?
 - c) A keni verifikuar përdorimin e fundit të antibiotikëve, alergjitë ndaj ilaçeve, përdorimin e terapisë immunosupresive, spitalizimin ose institucionalizimin e fundit, udhëtimet e fundit jashtë Evropës dhe rezultatet mikrobiologjike në 3 muajt e mëparshëm;
 - d) A ka pacienti një infeksion që mund të trajtohet me antibiotikë?

Nëse po:

- i. A merr pacienti antibiotikun(ët) e duhur dhe dozën e saktë në mënyrën e përshtatshme të administrimit?
- ii. A mund të përdoret një antibiotik me një spektër më të ngushtë për të trajtuar infeksionin?
- iii. Për sa kohë duhet të marrë pacienti antibiotik(ë)?

17. Të dokumentoni në regjistrin e pacientit arsyet për trajtimin me antibiotikë, përzgjedhjen e ilaçit, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit, në grafikun e pacientëve [31,42,70,71].

18. Bëhuni një burim i mirë informacioni për pacientët tuaj dhe ndihmohuni ata që të kuptojnë rëndësinë e përdorimit optimal të antibiotikëve. Sigurohuni që pacientët (dhe familjet e tyre) të kuptojnë arsyet e terapisë me antibiotikë dhe pikat kryesore që lidhen me përdorimin e antibiotikëve, duke përfshirë [konsensusin e ekspertëve]:

- a) Të marrin antibiotikët saktësisht siç përshkruhet nga mjeku;
- b) Të mos ruajnë kurrë antibiotikë për përdorim të mëvonshëm.
- c) Të mos përdorin kurrë antibiotikë të mbetur nga trajtime të mëparshme;
- d) Të mos shkëmbejnë kurrë antibiotikët e mbetur me njerëz të tjerë.